

# SHQIPËRIA DHE BASHKIMI EUROPIAN

## Falënderime

Instituti i Studimeve Ndërkombëtare i është mirënjohës Fondacionit Friedrich Ebert për mbështetjen e projektit “ Të kuptojmë Integrimin Europian”, komponent i të cilit është edhe ky botim informues rreth mardhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Europian, procesit të Integrimin , posaçërisht procesit të Stabilizim Asocimit, si dhe informacion rreth Bashkimit Europian, institucioneve dhe politikave të tij.

Instituti falënderon Dr. Arnold Wehmhoerner, i fondacionit Friedrich Ebert, për mbështetjen që dha për idenë fillestare të projektit, si dhe komentet rreth kësaj broshure. Gjithashtu falënderojmë për kontributin që dhanë në zbatimin e projektit Dr. Aleksandër Dhima, Kryetari i Zyrës së Fondacionit Friedrich Ebert në Tiranë, Z. Dritan Tola dhe Ylljet Aliçka nga Delegacioni i Komisionit Europian në Tiranë, Dr. Enika Abazi, Drejtore e Qendrës për Politikën Europiane dhe Integrimin, Dr. Ilir Yzeiri, Qendra Shqiptare "Shqipëria Europiane".



## INSTITUTI I STUDIMEVE NDERKOMBETARE (ISN)

Deshmoret e 4 Shkurtit No.7/1 Tirana Albania

Te: +355 4 248853 Fax +355 4 270337

Email :aiis@aiis-albania.org

ëëë.ais-albania.org

### PERMBAJTJA

## 1. SHQIPËRIA DHE BASHKIMI EUROPIAN

1—7

- a. Historia e marrëdhënieve Shqipëri-BE ..... 1—7
- b. Çfarë është integrimi evropian? ..... 1—8

## 2. PROCESI I STABILIZIM ASOCIMIT .... 2—9

- c. Si lindi ideja e Stabilizim-Asocimit? ..... 2—9
- d. Si zhvillohet procesi i Stabilizim Asocimit? ..... 2—10
  - Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe domethënia e saj ..... 2—11
  - Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe bashkëpunimi rajonal ..... 2—11
  - Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit ..... 2—11
    - Dialogu Politik ..... 2—11
    - Drejtesia dhe çështjet e brendshme ..... 2—12
    - Dialogu teknik: Lëvizja e lirë e mallrave ..... 2—12
    - Dialogu teknik: E drejta e vendosjes, lëvizja e lirë e punonjësve ..... 2—13
  - Përfitimet nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ..... 2—13
- e. Mbështetja e BE-së për Shqipërinë ..... 2—13

## 3. HISTORIA E BASHKIMIT EUROPIAN .. 3—

15

- f. Shtytja fillestare ..... 3—15
- g. Tri Komunitetet ..... 3—16
- h. Zgjerimi i parë ..... 3—17
- i. Zgjerimet e mëtejshme ..... 3—17
- j. Zgjerimi më i fundit ..... 3—17
- k. Hapa historikë ..... 3—18
- l. Institucionet kryesore të BE ..... 3—18
  - Këshilli i Europës ..... 3—18
  - Këshilli i Ministrave ..... 3—19
  - Presidenca ..... 3—19
  - Komisioni Evropian ..... 3—20
  - Parlamenti Evropian ..... 3—20
  - Gjykata Europiane e Drejtësisë ..... 3—21
- m. Politikrat kryesore të BE-së ..... 3—21
  - Politika e Përbashkët Bujqësore ..... 3—21
  - Politika e Konkurrencës ..... 3—22
  - Politika Ekonomike ..... 3—22
  - Politika Mjedisore ..... 3—22
  - Politika Sociale ..... 3—22
  - Politikat e kohezionit ..... 3—22



Lutz Salzmänn

## ***Europa: Bashkimi, një hap drejt botës së nesërme***

*Viti 2004 është një tjetër vit historik për Europën. 10 vende të reja nga Europa Qendrore dhe Lindore dhe Mesdheu iu bashkuan Bashkimit Europian më 1 maj 2004. Ne u urojmë mirëseardhjen në familjen tonë këtyre shteteve të reja anëtare dhe 75 milionë qytetarëve të rinj europianë.*

*Vetëm 14 vite më parë kjo gjë dukej si ëndërr, por ja që këto vende u shndërruan në shtete demokratike dhe me ekonomi tregu. Por kjo gjë nuk ishte fort e lehtë. Partnerëve tanë të rinj iu duhej të ristrukturonin thuajse çdo aspekt të sistemit të tyre politik, gjyqësor dhe ekonomik.*

*Bashkimi Europian është shembulli më i mirë institucional i ripajtimit historik. Më besoni, si një gjerman europian unë e di mirë ç'do të thotë kjo gjë. Të gjithë europianët festojnë sot faktin se nuk janë më të ndarë nga barriera ideologjike artificiale. Siç u shpreh edhe kryeministri irlandez dhe njëkohësisht kryetar i radhës i Këshillit Europian, z. Ahern, gjatë një vizite të kohëve të fundit në Pragë: "Zgjerimi ka të bëjë po aq me hapjen e mendësive sa edhe me atë të kufijve".*

*Më lejoni t'ju risjell fjalët e Zhan Monesë, babait të integritimit europian, i cili i mbyll kështu kujtimet e tij: "Bashkësia që kemi krijuar nuk është një qëllim në vetvete. Komuniteti... është vetëm një hap në rrugën drejt botës së organizuar të së nesërme".*

*Tani që kemi realizuar këtë ndërmarrje fantastike, na vjen sigurisht mirë t'u rithemi vendeve të tjera që nuk janë ende pjesë të BE-së, si Shqipëria, se zgjerimi nuk mund të konsiderohet i plotë derisa vendet e Ballkanit Perëndimor të mos jenë bërë anëtarë të tij.*

*Në këtë kontekst, Procesi i Stabilizimit dhe i Asociimit është shumë i krahasueshëm me instrumentin e Marrëveshjeve Europiane që vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, shumë prej të cilëve janë sot anëtarë të BE-së, nënshkruan dhe zbatuan para se të fillonin negociatat për anëtarësim. Zgjerimi i fundit duhet të konsiderohet si një inkurajim nga vendet e Ballkanit Perëndimor.*

*Europa është në një pikë kthese në historinë e saj. Ne sot kemi një Bashkim European më të madh e më të fortë, por shumë sfida na presin përpara pas këtij zgjerimi.*

*Gjithashtu, këtu në Shqipëri puna që duhet të kryejmë së bashku këtë vit dhe në vitet që do të vijnë është me rëndësi për të ardhmen e Shqipërisë në Europë. Unë shpresoj shumë që Shqipëria të mund t'i përgjigjet kësaj sfide. Të gjithë shqiptarëve, por veçanërisht brezave të rinj, duhet t'u krijohet perspektiva e një të ardhmeje më të mirë, e një mjedisi shoqëror dhe politik më të mirë ku të jetojnë.*



**Romano Prodi:**

*Historikisht dhe politikisht, tani Europa po hyn në një epokë të re. Vizioni i 12 vendeve të Europës Qendrore, Lindore dhe Jugore, për t'u futur në Bashkimin European është bërë realitet. Në Kopenhagen u vendos dhe duhet të them se ishte një vendim historik, të krijohet një Europë e vetme. Kjo tablo do të ishte e pakompletuar pa vendet ballkanike. Objektivi i integritimit european është të inkurajojë institucionet dhe politikatat e shteteve pjesëmarrëse të përqafojnë vlerat e përbashkëta të lirisë, sigurisë, drejtësisë e demokracisë.*

*Dua të theksoj veçanërisht rëndësinë e angazhimit dhe bashkëpunimit në drejtësi dhe çështjet e brendshme. Kjo do të thotë një bashkëpunim në mbarë Europën për çështjet e policisë dhe ato juridike, për kontrollin e kufijve dhe migracionit. Bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës, qenieve njerëzore dhe pastrimit të parave, tani është përparësi kryesore e Bashkimit European. Kjo bëhet akoma më kritike për vendet tona, ndërsa ne hapim kufijtë dhe lëvizja e lirë, që dikur ishte një parim abstrakt, bëhet realitet.*

*Unë personalisht besoj se populli shqiptar dhe institucionet e tij do të ndeshen me kujdes me këtë sfidë dhe do të bartin standardet europiane në vendin e tyre. Angazhimi, vendosmëria, durimi dhe realizmi janë bazat e strategjisë. Dhe Europa do të jetë në anën tuaj, me ndihmë, mbështetje, këshilla dhe inkurajim.*



Zhan Mone - Nese do te futet ndonje thenie e tij e shkurter

## **1. SHQIPËRIA DHE BASHKIMI EUROPIAN**

### **i. Historia e marrëdhënieve Shqipëri-BE**

Aspirata e Shqipërisë për t'iu bashkuar Europës mori jetë që nga fillimi i viteve '90, menjëherë pas shembjes së regjimit komunist. Është mjaft domethënës fakti që për shqiptarët ideja e ndryshimit u njëhsua me bashkimin me familjen e madhe europiane, nëpërmjet jehonës së njohur "E duam Shqipërinë si gjithë Europa". Rruga e vetme për tu ndarë me izolimin tragjik dhe prapambetjen e thellë ekonomike u njëhsua me integrimin European, përmes ndërtimit të demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me Bashkimin European në vitin 1990, të dy palët nënshkruan Marrëveshjen për Tregtinë dhe Bashkëpunimin në vitin 1992, e cila konkretizoi për herë të parë përpjekjet shqiptare për afrim dhe ndihmë nga Bashkimi European. Në vijim të kësaj marrëveshjeje,

Shqipëria mundi të përfitonte nga regjimet preferenciale tregtare që Bashkimi European u ofronte vendeve të treta.

Nga viti 1992 marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin European u bënë më të ngushta dhe u zgjeruan në disa fusha të ndryshme. Bashkimi European u bë donatori kryesor për Shqipërinë, duke ofruar mbështetje falas për zhvillimin e saj. Shqipëria nisi të përfitonte nga ndihmat e akorduara nga BE për vendet e Europës Lindore, të akorduara nga programi PHARE. Gjatë viteve 1991-1996 ndihma e përgjithshme e BE për vendin tonë llogaritet në rreth 511 milionë euro, një pjesë e së cilës përfshinte asistencë teknike, si konsulencë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë e administratës, trainime e studime; ndërsa pjesa tjetër është akorduar për investime në infrastrukturë, në sektorin e prodhimit, në atë shoqëror, në administratën publike dhe në zhvillimin rajonal. Shqipëria dëshmoi premisa të mira për një zhvillim të shpejtë, të cilat rreth vitit 1995 i shtynë autoritetet të bënin hapat e parë për nisjen e negociatave për marrëveshjen e asociimit. Ky vit përkon edhe me anëtarësimin e Shqipërisë në Këshillin e Europës, akt që dëshmonte për kontributin e madh për demokracinë në Shqipëri.

Kriza politike e mesit të viteve 90, e rënduar më tej nga kaosi i përgjithshëm në vend si pasojë e përmbysjes së skemave piramidale, shkaktuan ngrirjen e marrëdhënieve të vendit tonë me BE-në. Pavarësisht nga ripërtëritja e këtyre marrëdhënieve, si edhe kontributi i BE-së për përshpejtimin e reformave, gjendja vazhdonte të mbetej e nderë. Goditjet e rënda që kishin marrë shteti dhe ekonomia në vend, për shërimin e të cilave do të nevojiteshin vite, nxitën shqetësimin dhe skepticizmin e BE-së për t'i ngritur marrëdhëniet kontraktuale me Shqipërinë në një nivel më të lartë.

Zhvillimet tronditëse të fundviteve 90 në rajon, kriza e Kosovës dhe më tej konflikti etnik në Maqedoni e shtynë Bashkimin European t'i kushtonte gadishullit ballkanik një vëmendje më intensive. Vendet e tjera të rajonit, ashtu si edhe Shqipëria, kishin patur një ecje të vështirë drejt forcimit të demokracisë e zhvillimit të ekonomisë, në ndryshim nga simotrat e tyre të Europës Qendrore Lindore. Për të shmangur mundësinë e kultivimit të një vatre tensionesh në skajin juglindor të Europës, Bashkimi European u vendos të ofronte një qasje rajonale për vendet ballkanike, e cila evoloi më tej në të ashtuquajturin "Proces i Stabilizim Asociimit".

## **ii. Çfarë është integrimi europian?**

Integrimi nuk duhet keqkuptuar si eliminim i thjeshtë kufijsh, i cili do të bëjë të mundur lëvizjen e lirë drejt vendeve më të pasura të Europës. Integrimi në Bashkimin European nënkupton, në radhë të parë, përafrimin dhe përqafimin e vlerave themelore mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe jeton ky organizëm i madh ndërshtetëror:

- Demokracia, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare.

Të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit European funksionojnë mbi bazën e demokracive liberale, në të cilat shteti i së drejtës është i konsoliduar, ligji është i barabartë për të gjithë dhe të drejtat e njeriut janë të shenjta. Përqafimi i vlerave të demokracisë është vendimtar dhe themelor për vendet që aspirojnë për anëtarësim në BE. Në këto rrethana, një pjesë e konsiderueshme e ndihmës së akorduar nga BE për vendin tonë synon pikërisht në ndërtimin e këtyre vlerave.

- Ekonomi funksionale tregu, e aftë t'i bëjë ballë presioneve konkurruese dhe forcave të tregut brenda BE-së.

Përmbushja e dy kritereve të mësipërme, së bashku me detyrimin për të adoptuar legjislacionin e Bashkimit European, të ashtuquajturin *acqui communautaire*, janë parakushti kryesor për të mundësuar futjen e shteteve të treta në Bashkimin European.

Për shkak të një historie të gjatë izolimi e vështirësish ekonomike, integrimi perceptohet shpesh si mundësi për të lëvizur në Europë, duke lënë në harresë faktin se kjo lehtësi vjen vetëm si rezultat i konsolidimit të demokracisë dhe zhvillimit të ekonomisë. Procesi i integrimit duhet kuptuar si një program reformash që e afron vendin me modelin european të shtetit, demokracisë dhe funksionimit të ekonomisë, por jo thjesht si lëvizje e lirë drejt përfundimit. Së dyti, procesi duhet të përfshijë angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë, e jo vetëm Ministrisë së Integrimit.

## **2. PROCESI I STABILIZIM ASOCIMIT**

### **iii. Si lindi ideja e Stabilizim-Asocimit?**

Nevoja për të përkrahur stabilitetin ekonomik e politik në Europën Juglindore, si edhe për të nxitur reformat për vendosjen e shtetit ligjor, institucioneve të qëndrueshme dhe ekonomisë së

libre në vendet e rajonit nëpërmjet hapjes së perspektivës potenciale të anëtarësimit në BE dhe përkrahjes së thellimit të marrëveshjeve dypalëshe në rajon, e shtynë Bashkimin Europian të propozonte Procesin e Stabilizim Asocimit. Ky proces, i cili do të përfundojë me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit nga vendet e përfshira në iniciativë - Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Maqedonia, Serbia e Mali i Zi dhe Kroacia - bazohet në krijimin gradual të një zone të tregtisë së libre dhe në zbatimin e reformave të gjithanshme, të cilat kanë për synim përqafimin e standardeve europiane, për t'u afruar më tej me BE-në.

Në vetvete, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit nuk përbën një premtim për integrim. Ajo e vë theksin në stabilizimin e situatës në vendet përkatëse, për të arritur më tej në vendosjen e një marrëdhënieje speciale me Bashkimin europian. Megjithatë, në mënyrë të ngjashme me Marrëveshjet Europiane të nënshkruara në fillimvitet 90 me vendet europianolindore, tashmë anëtare të BE, ajo nxit përqafimin e vlerave themelore të Bashkimit Europian nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si demokracia dhe shteti ligjor, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe respektimi i pakicave kombëtare, ekonomia e tregut dhe drejtësia sociale. Po ashtu, kjo marrëveshje synon të nxitë edhe zhvillimin ekonomik të vendit, e mbështetur paralelisht nga programe ndihmesh të hartuara për të ndihmuar këto vende të përmbushin detyrimet e marrëveshjes.

#### **iv. Si zhvillohet procesi i Stabilizim Asocimit?**

Procesi i Stabilizim-Asocimit e vë theksin mbi stabilitetin, duke e parë si një mënyrë për të ulur nivelin e paqëndrueshmërisë që ka karakterizuar Shqipërinë në dhjetë vitet e fundit. Insistimi në bashkëpunimin e përbashkët rajonal nga ana e vendeve që synojnë të hyjnë në BE është një pjesë integrale e Procesit të Stabilizim-Asocimit.

Procesi i Stabilizim-Asocimit përfshin një numër aktiviteteve dhe marrëdhëniesh midis vendit të interesuar dhe Bashkimit Europian, si edhe një adoptim gradual të legjislacionit të BE-së prej vendit nënshkruar. Në mënyrë thelbësore ky proces përfshin vendosjen e një sërë marrëveshjesh dypalëshe midis vendit nënshkruar dhe BE-së në lidhje me, midis të tjerave, tarifave doganore për industrinë dhe bujqësinë, të drejtën e pronësisë intelektuale dhe procedurat e standardizimit e certifikimit.

Procesi i Stabilizim-Asocimit ka dy faza. Pasi BE merr vendim pozitiv mbi përshtatshmërinë e vendit të interesuar dhe aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e Marrëveshjes (finalizimi i

fazës së parë), hapet rruga për fillimin e fazës së dytë të Procesit të Stabilizim-Asocimit. Shqipëria ndodhet tashmë në fazën e dytë të këtij procesi, e cila përfshin procesin e negociatave mbi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, përfundimin dhe zbatimin efikas të Marrëveshjes. Negociatat mbi Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit janë veçanërisht të rëndësishme në këtë fazë, sepse atëherë vendosen kushtet për tarifatat bazë, që përcaktojnë marrëdhëniet tregtare midis vendit nënshkrues të Marrëveshjes dhe BE-së. Menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes, e cila bazohet në respektin për parimet demokratike dhe funksionimin e tregut të përbashkët, pala nënshkruese dhe BE fillojnë gradualisht të liberalizojnë tregjet e tyre. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit nuk përcakton paraprakisht një datë për anëtarësimin në Bashkimin Europian.

### ***Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe domethënia e saj***

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit është një marrëveshje ligjore ndërkombëtare midis vendit nënshkrues dhe BE-së, funksioni i së cilës është të vendosë një kornizë ligjore për bashkëpunim dhe adoptimin gradual të standardeve europiane. Ajo ofron mundësinë për bashkëpunim dypalësh dhe shtrin më tej hyrjen e lirë nga taksat të mallrave të shtetit nënshkrues në tregjet e BE-së.

### ***Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe bashkëpunimi rajonal***

Një nga karakteristikat kryesore të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit gjendet në paragrafët që vënë theksin në krijimin dhe forcimin e parimeve demokratike, si dhe në bashkëpunimin rajonal. Bashkëpunimi rajonal ka të bëjë me vendosjen e një rrjeti marrëveshjesh dy dhe shumëpalëshe ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor në fushën tregtare, ekonomike, ligjore dhe lloje të tjera bashkëpunimi. Kjo përjasje synon të krijojë e forcojë lidhjet mes vendeve ballkanike, duke sjellë frymën e bashkëpunimit e pajtimit, për të mënjanuar tensionet dhe për të nxitur zhvillimin reciprok.

### ***Negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit***

### Dialogu Politik

Parimet e Përgjithme të dialogut politik vendosin kushtet kryesore që përbëjnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të palëve, si respekti për parimet demokratike dhe ato të të drejtave të njeriut, respektimi i parimeve ligjore ndërkombtare dhe i shtetit të së drejtës, si dhe për parimet e ekonomisë së tregut. Në këto parime përfshihen edhe angazhimet që pala shqiptare duhet të marrë përsipër në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të rajonit në të gjitha fushat, atë të lëvizjes së lirë të personave, mallrave, kapitalit, shërbimeve, si dhe në luftën ndaj krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, migrimit të parregullt etj.

### Drejtësia dhe çështjet e brendshme

Shqipëria dhe Komuniteti European i kushtojnë rëndësi të veçantë forcimit të shtetit të së drejtës dhe institucioneve, si dhe bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit, pastrimit të parave dhe veprimtarisë kriminale. Negociatat mbi këtë fushë mbështeten në dy shtylla. Shtylla e parë ka të bëjë me bashkëpunimin në fushën e lëvizjes së personave dhe parashikon dispozita lidhur me vizat, azilin, migrimin dhe politika të tjera që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të njerëzve. Në këtë fushë Shqipëria ka arritur përparime të konsiderueshme, sidomos përsa i përket përmirësimit të legjislacionit. Sidoqoftë, mangësi ekzistojnë në menaxhimin e kufijve, regjimin e vizave, etj.

Shtylla e dytë ka të bëjë me bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, pastrimit të parave dhe drogave të paligjshme dhe parashikon dispozita mbi bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale. Në këtë fushë arritjet janë më modeste: në përgjithësi nuk është arritur të neutralizohet fenomeni i pastrimit të parave dhe ndërsa janë hedhur disa hapa me adoptimin e legjislacionit mbi luftën ndaj prodhimit lokal të drogës dhe penalizimit të shkelësve të ligjit, shumë pak është bërë për të parandaluar trafikimin e drogave të rënda.

### Dialogu teknik: Lëvizja e lirë e mallrave

Në përputhje me Marrëveshjen, Shqipëria dhe Komuniteti European duhet të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe kohore prej 10 vjetësh që nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit që pritet të ndodhë gjatë vitit 2004. Me fjalë të tjera, zona e tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe Komunitetit synon të hapë tregun shqiptar për eksportet e Komunitetit gjatë periudhës tranzitore, duke patur si qëllim konsolidimin e ekonomisë shqiptare, mbrojtjen e konsumatorit dhe nxitjen e biznesit. Kjo marrëveshje është asimetrike në favor të Shqipërisë, pra lehtësitë e siguruar prej saj do të përfitohen së pari nga

Shqipëria e më vonë nga BE. Në këtë kuadër bisedime janë zhvilluar për mallrat industriale, artikujt bujqësorë, etj.

*Dialogu teknik: E drejta e vendosjes, lëvizja e lirë e punonjësve*

Në këtë kapitull synohet trajtimi i barabartë i punonjësve shqiptarë dhe atyre komunitarë, të punësuar legalisht, me qëllim shmangien nga çdo lloj diskriminimi bazuar në kombësinë, përsa i përket kushteve të punës, shpërblimit apo pushimit nga puna. Gjithsesi, kjo nuk do të sjellë në të ardhmen e afërt mundësira më të mëdha aksesit të tregut komunitar, por vetëm lehtësira për punonjësit e punësuar ligjërish, familjet e tyre, si edhe lehtësirat e sistemeve të sigurimeve shoqërore e më tej. E drejta e vendosjes ka të bëjë me përcaktimin e një kuadri ligjor në lidhje me vendosjen e kompanive shqiptare dhe komunitare me të drejta reciproke dhe lehtësirat që do t'u jepen këtyre kompanive për të vepruar në tregjet përkatëse, me qëllim mënjanimin e çdo lloj diskriminimi. Gjithashtu në këtë kapitull përfshihen edhe çështje që kanë të bëjnë me mundësinë e njohjes së kualifikimeve profesionale reciproke dhe ushtrimin të aktiviteteve reciproke në fusha të caktuara.

***Përfitimet nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit***

Përfitimet më të rëndësishme, të drejtpërdrejta nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit janë në fushën e tregtisë dhe një hyrje më të lirë të prodhimeve vendase në tregun e përbashkët europian. Me përmirësimin e kushteve të eksportit lindin mundësi të shumta për zhvillimin e kompanive lokale dhe të ekonomisë kombëtare në përgjithësi.

Nga ana tjetër, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit mundëson një hyrje më të lehtë të mallrave europiane për blerësit dhe konsumatorët vendas, përmes procedurave administrative më të shkurtra, më efikase dhe me çmime më të ulta.

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit gjithashtu krijon mundësinë e marrjes së burimeve financiare prej fondeve të ndryshme strukturore, po ashtu ndihmë për ndërtimin e kapaciteteve institucionale, zhvillimin rajonal dhe pjesëmarrjen në mjaft projekte të BE-së, si p.sh. programet e shkëmbimit për profesorët dhe studentët, ose bashkëpunim midis qendrave të kërkimit në vend me ato të BE-së.

## v. Mbështetja e BE-së për Shqipërinë

Për realizimin e objektivave të Procesit të Stabilizim-Asocimit dhe të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, BE-ja ofron mbështetje financiare nëpërmjet programit CARDS (Ndihma Komunitare për Zhvillim, Rindërtim dhe Stabilizim), i cili zëvendësoi programet e mëparshme të ndihmës PHARE dhe OBNOVA. Në periudhën 2001-2004, ndihma e BE-së për Shqipërinë në kuadrin e Programit CARDS arrin në rreth € 180.000.000. Këto fonde, të destinuara për rindërtimin dhe infrastrukturën, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal, përqendrohen në disa fusha prioritare, si psh:

- Forcimi i administratës publike dhe gjyqësorit

Ky program synon të ndihmojë Shqipërinë për krijimin e një sistemi gjyqësor modern, të krahasueshëm me standardet europiane, nëpërmjet rishikimit të kuadrit ligjor, programeve të trainimeve, rehabilitimit e burgeve, etj. Po ashtu, përpjeke bëhen për të rritur profesionalizmin e shërbimit civil, me qëllim që administrata publike të jetë efikase dhe t'u përgjigjet standardeve të Bashkimit Europian.

- Policia e rendi publik

Në këtë fushë policisë shqiptare i janë ofruar këshilla strategjike, trainime e pajisje. Forcat policore kanë rol themelor në forcimin e shtetit ligjor, sigurisë së brendshme dhe luftës kundër krimit.

- Doganat

Misioni i Ndihmës për Doganat, i cili vepron në Shqipëri, ka arritur rezultate të vlefshme përse i përket vjeljes së të ardhurave, parandalimit të kontrabandës e korrupsionit e përmirësimit të manaxhimit e procedurave të doganave.

- Zhvillimi i infrastrukturës

Përmirësimi i rrjeteve të energjisë, transportit dhe ujit janë thelbësore për rritjen ekonomike në Shqipëri. Bashkimi Europian financon zhvillimin e disa projekteve për zhvillimin e infrastrukturës.

- Demokracia dhe të drejtat e njeriut

Bashkimi European ofron asistencë për organizatat që veprojnë në fushën e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Projektet mund të përfshijnë ndërgjegjësimin për rolin e të drejtave të njeriut në ndërtimin e shoqërisë civile, mbështetjen e programeve të mediave që promovojnë mirëkuptimin dhe tolerancën, riintegrimin e viktimave të trafikimit, etj.

- Arsimi

Në nivelin universitar, Shqipëria merr pjesë në programet e shkëmbimit TEMPUS. Universitetet shqiptare bashkëpunojnë me homologet europiane në projekte të përbashkëta. Gjithashtu, janë bërë plane edhe për mbështetjen e arsimit profesional.

- Zhvillimi i komuniteteve lokale
- Bujqësia
- Bashkëpunimi ndërkufitar
- Mjedisi

Krahas ndihmave të konsiderueshme që vendi ynë përfiton nga programet e ndihmës ekonomike, ai gëzon edhe preferenca tregtare në lidhje me BE-në. Një pjesë e mirë e prodhimeve vendase mund të hyjnë pa kufizime e dogana në tregjet europiane.

Sekreti i suksesit, sidoqoftë, qëndron në angazhimin e qenësishëm të vetë vendit. Procesi i Stabilizim Asocimit ka për qëllim të përkrahë e mbështesë proceset e brendshme të reformave që ka nisur vendi ynë, nëpërmjet ndihmës, preferencave tregtare, dialogut, konsulencës teknike dhe, së fundi, me anë të marrëveshjeve kontraktuale.

### **3. HISTORIA E BASHKIMIT EUROPIAN**

#### **vi. Shtytja fillestare**

Shtytja fillestare për themelimin e çka më vonë do të bëhej Bashkimi European ishte dëshira për ta rindërtuar Europën pas ngjarjeve shkatërrimtare të Luftës II Botërore, ashtu si edhe vullneti i mirë për të parandaluar shpërthimin e konflikteve të ngjashme në të ardhmen.

Me këtë synim, të shumtë ishin ata që mbështetnin idenë e krijimit të një lloj federate apo qeverie europiane. Adenauer, Çerçill, de Gasperi, Shuman e të tjerë vendosën të bindnin

popujt e tyre të hynin në një epokë të re. Në vitin 1946 Çerçilli mbajti një fjalim në Universitetin e Zyrihut, ku bëri thirrje për "Shtetet e Bashkuara të Europës", të ngjashme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rezultati i menjëhershëm i këtij fjalimi ishte themelimi i Këshillit të Europës. Megjithatë, Këshilli i Europës ishte (dhe mbetet) një organizatë e pafuqishme, një ekuivalente rajonale e Kombeve të Bashkuara (ndonëse ka krijuar pushtet në fushën e të drejtave të njeriut, nëpërmjet Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut).

## **vii. Tri Komunitetet**

Bashkimi European u krijua nga Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut, i cili u themelua në vitin 1951 nga gjashtë vende: Belgjika, Gjermania Perëndimore, Franca, Italia, Luksemburgu dhe Hollanda. Synimi i tij ishte të bashkonte burimet e çelikut dhe qymyrit të shteteve anëtare, në mënyrë që të shmangte një luftë tjetër në Europë. Kjo ide ishte frymëzuar nga një plan i zyrtarit francez Zhan Mone, me mbështetjen e ministrit të jashtëm francez Robert Shuman. Shumani kishte shpallur propozimin e tij për krijimin e një Europe të "organizuar", e cila sipas tij ishte e domosdoshme për ruajtjen e marrëdhënieve paqësore. Ky propozim, i njohur më vonë në histori si "Deklarata e Shumanit", konsiderohet si nismëtar i embrionit të Bashkimit European. Britanikët, gjithashtu të ftuar të merrnin pjesë në këtë iniciativë, refuzuan me pretekstin e sovranitetit kombëtar.

Gjashtë vendet anëtare të Komunitetit European të Karbonit dhe Çelikut vazhduan përpjekjet për të krijuar një Komunitet European të Mbrojtjes dhe një Komunitet Politik European. Synimi ishte krijimi i një ushtrie të përbashkët europiane, më mënyrë që Gjermania të mund të fillonte pa rrezik procesin e riarmatimit, për të dhënë kontributin e saj kundër kërcënimit sovjetik. KPE kishte për qëllim themelimin e një federate të shteteve europiane. Sidoqoftë, iniciativa u braktis pasi u hodh poshtë në parlamentin francez. Ideja e këtyre dy institucioneve, e cila u la mënjanë për vite të tëra, mori përsëri jetë në zhvillimet e mëvonshme, si shtylla e Politikës së Përbashkët të Jashtme e të Sigurisë, themeluar nga Traktati i Mastrihtit dhe Forca e Reagimit të Shpejtë Europiane, që po krijohet aktualisht.

Gjashtë vendet anëtare vijuan përçapjet për të thelluar integrimin e tyre, duke themeluar Komunitetin Ekonomik European dhe Komunitetin European të Energjisë Bërthamore. Synimi i KEE ishte të krijonte një bashkim doganor mes gjashtë anëtarëve themelues, të bazuar në konceptin e "katër lirive": liria e lëvizjes së lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Tarifat doganore ndërmjet gjashtë vendeve u hoqën plotësisht deri në vitin 1968 dhe

u vendosën politika të reja të përbashkëta, sidomos për tregtinë dhe bujqësinë. KEEB kishte për qëllim centralizimin e burimeve joushtarake bërthamore të këtyre vendeve. KEE, I themeluar nga Traktati I Romës (1957), ishte pa dyshim komuniteti më i rëndësishëm dhe më vonë u pagëzua me emrin e thjeshtë Komuniteti European.

#### **viii. Zgjerimi i parë**

Britania, e cila nuk dëshironte të bashkohej me Komunitetet, pasi ngurronte të dëmtonte tregtinë e saj me vendet e Komonuelthit, themeloi një organizatë alternative, Shoqata Europiane e Tregtisë së Lirë (EFTA). EFTA ishte thjesht një zonë tregtie e lirë dhe jo një bashkim doganor. Në të bënin pjesë gjithashtu Irlanda, Danimarka, Norvegjia, Suedia, Austria, Finlanda, Zvicra, Portugalia, Lihtenshtejni dhe Islanda.

Ndërkohë që rëndësia e tregtisë me Komonuelthin u zbeh dhe u rrit ajo europiane, Britania vendosi se bashkimi me Komunitetin do t'u shërbente interesave të saj. Në këtë vazhdë, Irlanda dhe Danimarka, të cilat tradicionalisht kishin qenë mjaft të varura nga tregtia me Britaninë, vendosën të aplikonin gjithashtu për anëtarësim. Dy aplikimet e para britanike për anëtarësim u hodhën poshtë, për shkak të vetos franceze të De Golit. Pas largimit të tij nga detyra, këto vende arritën të anëtarësoheshin në 1 janar 1973.

#### **ix. Zgjerimet e mëtejshme**

Me sukseset e njëpasnjëshme të Komunitetit European, gjithmonë e më shumë vende shfaqën dëshirën për t'u bërë pjesë e kësaj organizate. Në vitet 80 KE u zgjerua me Greqinë (1981) dhe më tej me Spanjën dhe Portugalinë (1986). Pas recesionit ekonomik të viteve '80, Presidenti i Komisionit European Zhak Delor propozoi një kalendar për krijimin e tregut të përbashkët european deri në 1 janar 1993. Komunitetet e përkrahën këtë synim ambicioz dhe e përfshinë atë në Aktin e Përbashkët European, i cili hyri në fuqi në vitin 1987. Austria, Suedia dhe Finlanda u pranuan në vitin 1995. Përpjekja e dytë e Norvegjisë për anëtarësim u hidh sërish poshtë nga elektorati norvegjez, referendumi i dytë i pasuksesshëm pas përpjekjes së vitit 1973. Me pranimin e Këtyre tri vendeve anëtarë të EFTA-s mbetën vetëm Norvegjia, Islanda, Lihtenshtejni dhe Zvicra.

#### **x. Zgjerimi më i fundit**

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, lindi sërish vullneti për ta ribashkuar Europën. Shtytja kryesore për këtë ishte dëshira për të thelluar marrëdhëniet me vendet e Europës Lindore, për të zhvilluar demokracinë dhe për të parandaluar rrezikun e rishfaqjes së komunizmit apo

diktaturave në këto vende. Vendet e ish-blokut sovjetik, si Çekia, Hungaria, Sllovakia, Polonia e të tjerë shprehën vullnetin e tyre për të bërë pjesë në familjen e madhe europiane, së cilës i përkisnin jo vetëm gjeografikisht, por edhe nga ana historike dhe kulturore. Përparimet e shpejta të këtyre vendeve për vendosjen e demokracisë, shtetit ligjor dhe funksionimit të ekonomisë së tregut i u dhanë shpejt të drejtën për të kandiduar për anëtarësim në BE. Zgjerimi më i fundit i Bashkimit European ndodhi në 1 Maj të këtij viti, kur 8 vende të ish-blokut sovjetik (Çeki, Sllovaki, Hungari, Poloni, Estoni, Letoni, Lituani, Slloveni) dhe Qipro e Malta u anëtarësuan në BE.

#### **xi. Hapa historikë**

Bashkimi European përbëhet nga vende sovrane, të cilat e kanë përqendruar sovranitetin e tyre në shumë fusha me rëndësi themelore ëpr qytetarët e tyre. Bashkimi European ka krijuar një monedhë të përbashkët dhe një treg të përbashkët në të cilin njerëzit, shërbimet, mallrat e kapitalet lëvizin lirisht. BE përpiqet të bëjë të mundur që, nëpërmjet përparimit shoqëror dhe konkurrencës së ndershme, sa më shumë njerëz të përfotijnë nga të mirat e tregut të përbashkët.

Bazat e Bashkimit European përcaktohen në disa traktate, ndër të cilët do të përmendnim:

- **Traktatin e Parisit**, me të cilin u themelua Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut në vitin 1951
- **Traktatet e Romës**, (1957) ku u krijuan Komuniteti Ekonomik European dhe Komuniteti European i Energjisë Bërthamore. KEE ishte zanafilla e në epoke të re në historinë europiane. Kur i referohemi "Traktatit të Romës", bëhet fjalë për traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik European.
- **Traktatit i Mاستrihtit**, (1993) ku KEE u pagëzua thjesht "Komuniteti European" dhe u krijua Bashkimi European, duke i shtuar fusha të reja bashkëpunimi ndërqeveritar sistemit të komuniteteve. Po ashtu, ky traktat vendosi edhe synime të reja për vendet anëtare: bashkimin monetar deri në vitin 1999, nënshtetësinë europiane, politika të reja të përbashkëta - përfshirë politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë.

#### **xii. Institucionet kryesore të BE**

### ***Këshilli i Europës***

Këshilli i Europës konsiston në takime të rregullta të kryetarëve të qeverive dhe/ose shteteve anëtare të Bashkimit Europian së bashku me Presidentin e Komisionit Europian. Roli i Këshillit të Europës është i dyanshëm. Së pari, ai siguron direktiva të përgjithshme politike për BE-në dhe së dyti, shërben për zgjidhjen e problemeve që kanë mbetur të pazgjidhura në nivelin e Këshillit të Ministrave. Këshilli i Europës ka qenë institucioni që i ka dhënë formë më tepër procesit të integritimit europian. Ai ka shërbyer si një arkitekt kushtetute, duke marrë vendimet më të rëndësishme, për shembull lidhur me zgjerimin e BE-së dhe bashkimin ekonomik e monetar. Po ashtu Këshilli i Europës ka vendosur planin e punës së procesit të integritimit; dhe së fundi, ka marrë vendime të rëndësishme për një gamë të gjerë çështjesh.

### ***Këshilli i Ministrave***

Anëtarët e Këshillit të Ministrave janë ministrat e qeverive të vendeve anëtare të BE-së, të cilët përfaqësojnë qëndrimet e qeverive të tyre. Në të vërtetë nuk ka një ‘Këshill’ të vetëm, por disa ‘Këshille’. Kjo do të thotë që kur diskutohet për një çështje ekonomike, Ministrat e Ekonomisë së vendeve anëtare të BE-së mblidhen në Këshillin e Ekonomisë dhe Financës, ose kur diskutohet për një çështje bujqësore Ministrat e Bujqësisë mblidhen në Këshillin e Ministrave të Bujqësisë.

Këshilli i Ministrave është organi kryesor vendimmarrës i BE-së, gjë që nënvizon se shtetet anëtare të BE-së e kanë lëshuar pushtetin dhe dëmtuar sovranitetin e tyre vetëm në një masë të vogël. Po të krahasohen pushtetet e Këshillit të Ministrave, si përfaqësues i interesit kombëtar, me ato të Komisionit ose Parlamentit Europian, si përfaqësues të interesit komunitar (mbikombëtar), shihet se ende Këshilli i Ministrave ka më tepër kompetenca lidhur me çështjet vërtet delikate dhe themelore të shteteve anëtare. Ai ka pushtet legjislativ dhe ekzekutiv. Në rast se do të provonim ta fusnim Këshillin e Ministrave në ndarjen klasike të pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, ku përkatësisht këtë pushtet e kanë parlamenti, qeveria dhe gjykatat, Këshilli luan më tepër rolin e parlamentit. Disa nga vendimet e marra nga Këshilli i Ministrave mund të jenë të ligjërishme të detyrueshme për shtetet anëtare dhe disa të tjera jo. Meqënëse vendimet në Këshillin e Ministrave merren me shumicë votash, vendet me popullsi më të madhe që kanë në dispozicion më shumë vota, ndikojnë më tepër në marrjen e vendimeve.

## ***Presidenca***

Çdo shtet anëtar i BE-së ka të drejtën të jetë president i Këshillit për gjashtë muaj në bazë të një sistemi rotacioni, gjë që do të thotë se ai vend ka përgjegjësinë të organizojë të gjithë punën e Këshillit të Ministrave dhe Këshillit të Europës: kryesimin e afërsisht 200 takimeve, arritjen e marrëveshjeve, fillimin e iniciativave të politikave strategjike, të qënurit zëdhënës i BE-së, përfaqësimin e BE-së në arenën ndërkombtare, administrimin e veprimtarive të BE-së lidhur me Politikën e Përbashkëta të Jashtme dhe mbi Sigurinë, si dhe lidhur me Çështjet e Brendshme dhe të Drejtësisë.

## ***Komisioni European***

Komisioni European përbëhet nga komisionerët dhe nga një numër i vogël nëpunësish (afërsisht 21,000 të punësuar), po të merren parasysh qëllimi, funksionet dhe përgjegjësitë e tij. Për momentin, vendet e mëdha përsa i përket numrit të popullsisë kanë të drejtën të emërojnë dy komisionerë në Komisionin European, ndërsa vendet më të vogla vetëm një. Teorikisht të gjithë komisionerët janë të barabartë, por gjatë kohës ka lindur një lloj hierarchie midis tyre, e kushtëzuar nga rëndësia praktike që paraqet fusha për të cilën ata janë përgjegjës. Në veçanti është rritur rëndësia e presidencës së Komisionit.

Komisioni European është një kombinim i roleve administrative, ekzekutive, legjislativ dhe gjyqësore. Por nëse përsëri do të mundoheshim ta klasifikonim këtë institucion sipas ndarjes klasike të pushteteve të përmendur më lart, Komisioni European është më tepër i ngjashëm me qeverinë. Së pari, Komisioni propozon legjislacionin lidhur me shtyllën e parë të BE-së, që ka të bëjë me tregun e përbashkët europian, politikën bujqësore, strukturore dhe ato të tregtisë. Së dyti, Komisioni ekzekuton ose zbaton legjislacionin në fushat e përmendura më sipër. Së treti, së bashku me Këshillin e Ministrave, Komisioni European vendos për buxhetin e BE-së. Së katërti, Komisioni zhvillon marrëdhëniet me jashtë në formën e marrëveshjeve që negocohen me vendet e treta, lidhur me tregtinë, ndihmën dhe asocimin, duke përfaqësuar BE-në në këto negociata. Së fundi, Komisioni vepron si ‘gardian i marrëveshjeve’ të arritura midis shteteve anëtare të BE-së. Ai ka të drejtën të çojë shtetet anëtare në Gjykatën Europiane të Drejtësisë, kur ka zëra që pretendojnë për mospërmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet.

### ***Parlamenti European***

Parlamenti European zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe përfshin anëtarë nga të gjitha vendet anëtare të BE-së me një mandat 5-vjeçar. Me zgjerimin e ri në lindje të BE-së, numri i europarlamentarëve duhet t'i kalojë të 700 vetët. Duhet thënë se Parlamenti European nuk është një aktor kryesor në marrëdhëniet me jashtë të BE-së, por roli i tij po vjen duke u rritur.

Pushtetet e Parlamentit European kanë të bëjnë me legjislacionin, buxhetin, marrëveshjet me jashtë dhe emërimet. Megjithëse Parlamenti nuk ka pushtetin të propozojë legjislacion, ai duhet të konsultohet në pothuaj të gjithë legjislacionin e Komunitetit European, duke ushtruar kështu një lloj kontrolli demokratik mbi vendimet e marra nga BE. Sidoqoftë, pavarësisht nga emërtimi, institucioni i Parlamentit European është shumë larg asaj çka kuptohet me parlament në teorinë klasike të ndarjes së pushteteve dhe që mishërohet në parlamentet kombëtare.

### ***Gjykata Europiane e Drejtësisë***

Ky institucion i përbërë nga një gjykatës për çdo shtet anëtar, të cilët zgjidhen nga qeveritë kombëtare për një periudhë të përsëritshme 6-vjeçare, ka autoritetin më të lartë ligjor në BE. Gjykata Europiane e Drejtësisë ka tri funksione kryesore. Ajo ndihmon të sigurohet që institucionet e BE-së nuk e kapërcejnë autoritetin e tyre, ndihmon në zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve midis institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare dhe, së fundi, ndihmon të sigurohet pranimi i ligjeve të Komunitetit European nga ana e shteteve kombëtare. Rastet e shqyrtuara nga Gjykata Europiane e Drejtësisë dhe vendimet e marra nga ana e saj kanë ndihmuar në vendosjen e supremacisë së të drejtës komunitare mbi atë kombëtare, kur këto të drejta janë në konflikt me njëra-tjetrën.

### **xiii. Politikat kryesore të BE-së**

### ***Politika e Përbashkët Bujqësore***

Synimi i Politikës së Përbashkët Bujqësore është të rrisë rendimentin bujqësor në mënyrë që të sigurohet standard i mirë jetese për personat që merren me bujqësi; të stabilizojë tregjet dhe të sigurojë të mira të vazhdueshme me çmime të arsyeshme për konsumatorët.

### ***Politika e Konkurrencës***

Synimi i Politikës së Konkurrencës është të krijojë e ruajë një sistem që lejon konkurrencën e drejtë brenda një rajoni ekonomik. Politika e konkurrencës synon të sigurojë tregje me konkurrencë të përsosur, me përpjekjen për të parandaluar shfaqjen e monopoleve e oligopoleve, të cilat mund të diktojnë çmime në dëm të konsumatorëve. Monopolet lejohen vetëm në raste të veçanta, për të garantuar të mira a shërbime me interes të konsiderueshëm publik. Për shembull, Europa ka monopole shtetërore në shërbimet e transportit, postës e telekomunikacionit.

### ***Politika Ekonomike***

Politika ekonomike synon rritje të qëndrueshme e të balancuar, rritjen e standardit të jetesës, punësimin e lartë, çmime të qëndrueshme, financa publike e kushte monetare të shëndetshme, si edhe bilanc të qëndrueshëm pagesash.

### ***Politika Mjedisore***

Politika mjedisore synon të përmirësojë cilësinë e mjedisit; të mbrojë shëndetin e popullsisë; përdorimin e kujdesshëm e racional të burimeve natyrore; promovimin e masave të nivelit ndërkombëtar për tejkalimin e problemeve mjedisore rajonale e të shkallës më të gjerë.

### ***Politika Sociale***

Politika sociale synon të përmirësojë kushtet e jetesës e punës; të stimuljë punësimin dhe barazinë e mundësive; mbrojtjen minimale sociale.

### ***Politikat e kohezionit***

Politika e kohezionit - që përfshin politikën rajonale (reduktimi i pabarazive, rigjenerimi i zonave të vjetra industriale dhe asistenca për zhvillimin rural), aspekte të politikës sociale (lufta kundër papunësisë së gjatë dhe ndihmesa e arsimimit e trainimit profesional), si edhe një

pjesë të vogël të Politikës së Përbashkët Bujqësore (asistenca për zhvillimin rural) - është zhvilluar relativisht vonë në historinë e BE-së. Thelbi i saj është të "redukojë pabarazitë mes rajoneve të ndryshme e prapambetjen e vendeve më pak të favorizuara:, me anë të fondeve strukturore.

### ***Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë***

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e sigurisë është një sistem unik bashkëpunimi mes vendeve anëtare të BE-së në çështjet politike ndërkombëtare. Ajo përbën shtyllën e dytë të Bashkimit European, pas Komunitetit European (shtylla e parë). Synimi i politikës së jashtme të përbashkët është të ruajë identitetin e Bashkimit European në skenën ndërkombëtare. Objektivat e saj më të rëndësishme janë shkëmbimi i vazhdueshëm i informacionit e opinioneve mbi çështjet politike ndërkombëtare, bashkërendimi i pozicioneve kombëtare, kryesisht duke adoptuar një qasje në themel të përbashkët dhe vënia në jetë e këtyre pozicioneve me anë të veprimeve të përbashkëta.